KËRKESË
Nr.216, datë 14.1.2010

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Mbështetur në ligjin nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken si rezultat i ndërtimit të segmentit rrugor "Himarë e Vjetër-Potam".

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i posaçëm i shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Sqarojmë që kjo shpallje kërkese për shpronësim, bëhet vetëm për pasurinë e llojit truall.

Pronarët për të cilët në kolonën "shënime" në tabelën e publikuar, është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZRPP", do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues, në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik").

Vlera totale e këtij shpronësimi është 4 115 200 (katër milionë e njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e dyqind) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA E SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR "HIMARË E VJETËR-POTAM"

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Nr. regjistri hipotekar	Sip m^2 (truall)	Çmimi	Vlera	Vlera Totale (lekë)	Shënime
1	Katina		Kacelano	1952	1027	92	3200	294400	294400	Vërtetim hipotekor
2	Koste		Dhima	1952	708	839	3200	2684800	2684800	Vërtetim hipotekor
3	Nikollaq		Duko	1952	87	355	3200	1136000	1136000	Vërtetim hipotekor
	Totali					**1286**		**4115200**	**4115200**	